



Pranuar / Dorezuar Punimje/Prodote Received/Deliverty	29-06-2021	viti god year	2021
Organ /Njësia Organ /ćedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
BKIMACK	3371/2021		113

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A. Nr.426/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj–Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.426/2021 të datës 20.05.2021, të parashtruar nga Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridik “*Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.426/2021 të datës 20.05.2021, e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 20.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2495/2021 të regjistruar me numër A.nr.426/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkak të mos harmonizimit të koeficientit të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 26.05.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankueses me numër protokollit 2645/2021 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 426/2021, e datës 20.05.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për



përgjigje në ankesë e datës 25.05.2021; Akt Emërimi i datës 06.03.2013; Vendim i datës 03.04.2017; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 09.01.2018; Kërkesë për ndryshim të kontratës i datës 27.03.2017; Përgjigje në ankesë e datës 26.05.2021; E-mail nga R.H. për C.Z. i datës 26.05.2021; Kërkesë për ndryshim të kontratës i datës 15.01.2018; Vendim i datës 09.02.2021; Vërtetim për ndryshime formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 10.02.2021; E-mail nga XH.Z. për R.H. i datës 16.02.2021; E-mail nga R.H. për XH.Z. i datës 11.02.2021; E-mail nga SH.D. për R.H. i datës 10.02.2021; E-mail nga R.H. për SH.D. i datës 10.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 14.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 10.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 10.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.12.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 16.12.2016; Akt Emërimi i datës 18.03.2015;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankueses është parashtruar jashtë afatit ligjor, *sepse,*

Nga shqyrtimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesja është e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe se njëjta sipas Vendimit të datës 03.04.2017 të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, është caktuar në pozitën e Zyrtares për Depozitat e të Burgosurve në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, e të cilën pozitë sipas Ndryshim dhe Plotësim Aktit të Emërimit të datës 09.01.2018 e ushtron edhe sot.

Bazuar në kërkesën e ankueses, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me Vendimin me numër protokoll 0387 të datës 09.02.2021, ka aprovuar kërkesën e ankueses për nivelizimin e koeficientit të pagesës nga gjashtë (6) në shtatë (7).

Ndërsa në përgjigjen në ankesë, organi i punësimit deklaron së ankuesja disa herë ka parashtruar kërkesë për nivelizimin e pagës, po qe vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm i datës 09.02.2021, nuk është zbatuar nga Thesari i Kosovës.

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ankuesja pretendon se organi i punësimit, respektivisht Shërbimi Korrektues i Kosovës me mos harmonizimin e koeficientit të pagës ka bërë diskriminim në raport me detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe se kolegjet e saj me pozitë të njëjtë pune kanë koeficient shtatë (7) të pagës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Vendimin e datës 09.02.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, për nivelizimin e koeficientit të pagesës se ankueses nga gjashtë (6) në shtatë (7), Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i





ankesës me datë 20.05.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kështu që bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda Nr. A. Nr. 426/2021

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

